

VENDIM
Nr.24, datë 3.7.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hi1mi Dak1i, Anëtar i“““

Mano1 Konomi, Anëtar i “““

Ve1i Budo, Anëtar i“““

Zija Vuci, Anëtar i “““

Franc Jakova, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Ha1i1 Kopani, Anëtar i“““

Alfred Karamuço, Anëtar i“““

me sekretare Drita Fi1to, më datën 2.7.1997, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.28 Akti që u përket:

KËRKUES: REMZI PONARI

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE përfaqësuar nga Z.Kujtim Puto.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i vendimit nr.899 të datës 27. 6.1997 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi kërkesin dhe përfaqësuesin e subjektit të interesuar

,

V Ë R E N:

Kërkesi Remzi Ponari është regjistruar nga komisioni i zgjedhjeve të zonës elektorale nr.49 si kandidat për deputet në Kuvendin Popullor në zgjedhjet e datës 29 qershor 1997, i subjektit elektorale Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare.

Ai është ankuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për shkak se emri i tij nuk ishte i regjistruar në fletët e votimit.

Në datën 27 qershor 1997, në mbrëmje, i është komunikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendimi nr.899, datë 27.6.1997, me të cilin ankimi është refuzuar me arsyetimin se dokumentacioni përkatës është paraqitur me vonesë në këtë Komision.

Në bazë të nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 (me ndryshimet përkatëse) "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", ankimet ndaj Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, paraqiten në Gjykatën Kushtetuese brenda tre ditëve nga shpallja e tyre. Kërkesi në Gjykatën Kushtetuese ka paraqitur kërkesën në datën 2.7.1997, jashtë afatit ligjor. Këtë vonesë kërkesi nuk e motivon me asnjë shkak apo pengesë me karakter objektiv.

Gjatë shqyrtimit të çështjes kërkesi pretendoi se ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 27.6.1997 një kërkesë e për pasojë ishte brenda afatit ligjor. Por ky pretendim rrëzohet si nga dokumentat e paraqitura ashtu dhe nga vetë shpjegimet e tij nga ku del se në kohën kur ai pretendon se ka paraqitur kërkesën, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk kishte marrë ende vendimin.

Në këto kushte, kur kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, ajo duhet rrëzuar pa hyrë në shqyrtimin në themel të çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 pika 7 e ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", dhe nenit 50 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor" , njëzëri,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë. Tiranë, më 3.
7.1997